



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

Nr 3307/1 Prot

Datë 29 / 09 / 2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për : “ Viante Konstruksion ” shpk

Me adresë : Lagjia “Sporti” Gramsh

ELBASAN

Procedura e prokurimit : Procedurë e Hapur – Punë Publike.

Numri i referencës së procedurës : REF-67836-08-05-2020 .

Përshkrim i shkurtër i kontratës , objekti : **“Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara”** , me fond limit me vlerë : **24 209 728** (njëzetë e katër milion e dyqind e nëntë mijë e shtatëqind e njëzetë e tetë) **lekë pa tvsh** .

Afati për ekzekutimin e kontratës : Do të jetë 4 (katër) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve nga autoriteti kontraktor .

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Çmimi më i ulët **X**

Njoftojmë se në procedurë kanë ofertuar **10** (dhjetë) operator ekonomik dhe konkretisht si më poshtë :

1. **“ B - 93 ”** shpk me Nr NIPT-i **J 62903508 R** me ofertë ekonomike : **19 242 695** (nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e dyzetë e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh .

2. “ **Colombo** ” shpk me Nr NIPT-i **J 82916489 E** me ofertë ekonomike : **19 130 984** (nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh .
3. “ **Ed Konstruksion** ” shpk me Nr NIPT-i **K 61625001 I** me ofertë ekonomike : **24 049 619,3** (njëzetë e katër milion e dyzetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë pikë tre) lekë pa tvsh .
4. “ **Elda-VL** ” shpk me Nr NIPT-i **K 67106202 W** pa ofertë ekonomike .
5. “ **Fled** ” shpk me Nr .NIPT-i **K17621104C** me ofertë ekonomike : **16 944 775** (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzetë e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh .
6. “ **Leon Konstruksion** ” shpk me Nr .NIPT-i **K 71820009 I** me ofertë ekonomike : **21 801 363.5** (njëzetë e një milion e tetëqind e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesë) lekë pa tvsh .
7. “ **Rafin Company** ” shpk me Nr NIPT-i **L 52125110 A** me ofertë ekonomike : **19 950 493** (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa tvsh .
8. Bashkimi i operatorëve ekonomik “ **Spektri** ” shpk me Nr NIPT-i **J 62903555 F** dhe “**Jogi** ” shpk me Nr NIPT-i **J 63229478 K** me ofertë ekonomike : **20 669 421.5** (njëzetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzetë e një pikë pesë) lekë pa tvsh .
9. “ **Shendelli** ” shpk me Nr NIPT-i **K 07924803 N** me ofertë ekonomike : **20 869 664** (njëzetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa tvsh .
10. “ **Viante Konstruksion** ” shpk me Nr NIPT-i **K 47103804 L** me ofertë ekonomike : **23 090 997** (njëzetë e tre milion e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh .

* * *

Janë skualifikuar operatorët ekonomik ofertues si më poshtë :

1. “ **B – 93** ” shpk rezulton me mangësi në dokumentacion si më poshtë :
 - Nuk ka paraqitur faturë tatimore për punime të ngjashme.
 - Nuk ka paraqitur punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila duhet të jetë lëshuar nga shoqëri të akredituar

ose nga organizma ndërkombëtar akreditues të shoqëruar me kontratë pune certifikatë përkatëse dhe të figurojë në listëpagesa për 6 muajt e fundit.

- Nuk ka paraqitur të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik për 3 (tre) specialistë ndërtimi si dhe punonjës në lartësi nga 4 (katër) që kërkohen ka paraqitur 3 (tre).
- Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës më shumë se 15 ton kërkohen 2 (dy) mjete ka paraqitur vetëm 1 (një) me dokumentacion të rregullt.
- Kamion vetëshkarkues me kapacitet 3.5 - 5 ton kërkohen 2 (dy) mjete ka paraqitur vetëm 1 (një) me dokument të rregullt.
- Kamioncinë me kapacitet mbajtës 1.5 – 3 ton kërkohen 2 (dy) mjete dhe nuk ka paraqitur asnjë me dokumentacion të rregullt.
- Autobetonieret dhe autobot uji (nuk ka dokumentacion të rregullt për arsye se dokumentat e paraqitura për këto mjete që i ka me kontratë qeraje janë kamiona për transport mallrash, për llogari të vet pronarit dhe jo për të tretët , kjo në kundërshtim të nenit 41 të ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “ Për transportet rrugore “. Për mungesat e lartpërmendura skualifikohet.

2. “ Colombo “ sh.p.k rezulton me mangësi në dokumentacion si më poshtë:

- Në shtojcën 11 nuk janë deklaruar të gjitha kontratat në proces ose procedurat që është shpallur fitues. Konkretisht në Buletinin 64 datë 03.09.2020 OE Colombo sh.p.k së bashku me disa operatorë është shpallur fitues në procedurën e prokurimit në objekt “ Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Kavajë dhe Rrogozhinë me fond limit 243 987 406 lekë pa t.v.sh i shpallur nga FSHZH dhe nuk e ka deklaruar sic është kërkuar në DST. Rastet e mosdeklarimit të një dokumenti ose të dokumentave të rreme e të pa sakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.
- Sipas objektit të QKB-së OE ka aktivitet në adresën Vranisht “ Rikonstruksion me shtesë kati në objekt ekzistues dhe katua “ në ZK 3823 me nr. Pasurie 24/2 vol4 faqe 50 (adresë e cila vazhdon të jetë e hapur edhe datën e zhvillimit të procedurës 07.09.2020. Nuk keni paraqitur vërtetim për shlyerjen e të gjitha detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore .
- Në liste-pagesat e paraqitura pak punonjës janë me kohë të plotë pune. Mbështetur në ligjin nr. 7961,datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kodi i Punës, Kreu V, neni 12,

specifikohet: "Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim". Në kërkesat për kualifikim përcaktohet kërkesa për 50 punonjës dhe shmangia apo deklarimi i pak ditëve pune nuk provon kapacitetin teknik të kërkuar në kërkesën e mësipërme. Në kontratën e punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit përcaktohet se kontrata është me kohe të plote ndërsa në listë pagesat shumica e punonjësve janë deklaruar me kohë të pjesshme dhe kanë punuar vetëm pak dite. Vendosija e kërkesave për kualifikim i shërben autoritetit për të garantuar zbatimin me sukses të kontratës kur nga ana tjetër OE nuk garanton as zbatimin e një kontrate mes tij dhe punëmarrësit, një shkelje kjo dhe për sa i përket legjislacionit të Kodit të Punës. Përsa me lart OE nuk ka plotësuar kriterin e mësipërm.

- Faturat Tatimore të Shitjes bashkëlidhur kontratave të sipërmarrjes janë të paplotësuara në të gjitha elementet dhe të pafirmosur nga blerësi .
- Kamioni me targa AA134HS ka skaduar taksat vjetore, dhe nuk plotëson kushtin për të patur 2 kamiona me kapacitet mbi 15 ton .

3. “ **Elda-VL** ” shpk skualifikohet për shkak se nuk ka paraqitur asnjë dokument .

4. “ **Fled** ” shpk rezulton me mangësi në dokumentacion si më poshtë :

- Nuk ka paraqitur punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave e cila duhet jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë të shoqëruar me kontratë pune, çertifikatë përkatëse dhe të figurojë në listëpagesa për 6 muajt e fundit.
- Eksperti zjarrëfikës i paraqitur nga ana juaj nuk është i punësuar me kohë të plotë sipas listëpagësave të paraqitura nga ana juaj mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kodi i Punës, Kreu V, neni 12, specifikohet: "Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr

përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim".

- Nuk ka paraqitur dokumenta për kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton .
 - Nuk ka paraqitur dokumenta për kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton.
 - Kamioncina me kapacitet mbajtës nga 1.5-3 ka paraqitur vetëm një nga dy të kërkuara.
 - Autoboti i ujit është pa çertifikatë për transport mallrash.
- 5. “ Leon Konstruksion ”** shpk rezulton me mangësi në dokumentacion si më poshtë :
- Në listë-pagesat e paraqitura pak punonjës janë me kohë të plotë pune, mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kodi i Punës, Kreu V, neni 12, specifikohet: *"Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim".* Në kërkesat për kualifikim përcaktohet kërkesa për 50 punonjës dhe shmangia apo deklarimi i pak ditëve pune nuk provon kapacitetin teknik të kërkuar në kërkesën e mësipërme. Në kontratën e punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit përcaktohet se kontrata është me kohë të plotë ndërsa në listë pagesat shumica e punonjësve (përfshirë punonjësit e kërkuar ne DST) janë deklaruar me kohë të pjesshme dhe kanë punuar vetëm pak dite. Vendosija e kërkesave për kualifikim i shërben autoritetit për te garantuar zbatimin me sukses të kontratës kur nga ana tjerë OE nuk garanton as zbatimin e një kontrate mes tij dhe punëmarrësit, një shkelje kjo dhe përse i përket legjislacionit të Kodit të Punës. Përse me lart OE nuk ka plotësuar kriterin e mësipërm.
 - Autobetonieret me targë AA693RV dhe AA694RV ju ka mbaruar siguracioni që në datë 06.09.2020, kur data e hapjes se ofertave ishte data 07.09.2020 dhe nuk e plotëson kushtin për të patur dy autobetoniere.
 - Kamion vetshkarkues me kapacitet 3.5-5 ton kërkohen 2 mjete (ka paraqitur vetëm 1).
 - Kamion vetshkarkues me kapacitet 1.5-3 ton kërkohen 2 mjete (nuk ka dokumentacionin e duhur për arsye se dokumentat e paraqitura për këto mjete që i ka me kontratë qeraje janë kamiona për transport mallrash për llogari të vet pronarit dhe jo për qera për të tretër, kjo në kundërshtim të nenit 41 të ligjit nr.8308 datë 18.03.1998 “Per transportet rrugore”).
 - Nga gjashte inxhinieret e kërkuar që janë drejtues teknik, kërkohen që 2 prej tyre të jenë të pajisur me çertifikatë trajnimi për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, nga ana juaj është paraqitur vetëm 1.
- 6. Bashkimi i operatorëve ekonomik “ Rafin + 2Z konstruksion ”** shpk rezulton me mangësi në dokumentacion si më poshtë:

- 2Z konstruksion nuk ka paraqitur ing. Hidroteknik, duhet të paraqesi për shkak se në kontratën e bashkëpunimit ka parashikuar se në preventiv ka punime hidro, për rrjedhojë duhet plotësuar dhe ky kriter.
 - Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës më shumë se 15 ton, kërkohen dy mjete, ka paraqitur vetëm një me dokument të rregullt.
 - Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton kërkohen dy mjete, nuk ka paraqitur asnjë me dokument të rregullt. (nuk ka dokumentacionin e duhur për arsye se dokumentat e paraqitura për këto mjete që i ka me kontratë qeraje janë kamiona për transport mallrash për llogari të vet pronarit dhe jo për qera për të tretët, kjo në kundërshtim të nenit 41, të ligjit nr.8308 date 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).
 - Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 1.5-3 ton, kërkohen dy mjete, nuk ka paraqitur asnjë me dokument të rregullt. (nuk ka dokumentacionin e duhur për arsye se dokumentat e paraqitura për këto mjete që i ka me kontratë qeraje janë kamiona për transport mallrash për llogari të vet pronarit dhe jo për qera për të tretët, kjo në kundërshtim të nenit 41 të ligjit nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).
 - Autobetonieret dhe autoboti i ujit (nuk ka dokumentacionin e duhur për arsye se dokumentat e paraqitura për këto mjete që i ka me kontratë qeraje janë kamiona për transport mallrash për llogari të vet pronarit dhe jo për qera për të tretët, kjo në kundërshtim të nenit 41 të ligjit nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).
7. Bashkimi i operatorëve ekonomik “ **Spektri + Jogi** ” shpk rezulton me mangësi në dokumentacion si më poshtë :
- Jogi nuk ka paraqitur listëpagesat për punonjësit e kërkuar.
 - Nuk ka paraqitur punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik për tre specialistë ndërtimi.
 - Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton kërkohen 2 (dy) mjete, ka paraqitur vetëm një mjet me dokument të rregullt. (nuk ka dokumentacionin e duhur për arsye se dokumentat e paraqitura për këto mjete që i ka me kontratë qeraje janë kamiona për transport mallrash për llogari të vet pronarit dhe jo për qera për të tretët, kjo në kundërshtim të nenit 41 të ligjit nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).
 - Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 1.5-3 ton, kërkohen dy mjete, ka paraqitur vetëm një mjet me dokument të rregullt. (nuk ka dokumentacionin e duhur për arsye se dokumentat e paraqitura për këto mjete që i ka me kontratë qeraje janë kamiona për transport mallrash për llogari të vet pronarit dhe jo për qera për të tretët, kjo në kundërshtim të nenit 41 të ligjit nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).
 - Një autobetoniere dhe autoboti i ujit (nuk ka dokumentacionin e duhur për arsye se dokumentat e paraqitura për këto mjete që i ka me kontratë qeraje janë kamiona për transport mallrash për llogari të vet pronarit dhe jo për qera për të tretët, kjo në kundërshtim të nenit 41 të ligjit nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).

8. “ **Shendelli** ” shpk rezulton me mangësi në dokumentacion si më poshtë :

- Faturat Tatimore të shitjes bashkëlidhur kontratave të sipërmarrjes janë të paplotësuara në të gjitha elementet dhe të pafirmosur nga blerësi.
- Nuk ka paraqitur punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave e cila duhet jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë të shoqëruar me kontrate pune, çertifikatë përkatëse dhe të figurojë në listëpagesa 6 muajt e fundit.
- Nuk ka paraqitur punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik për një teknik ndërtimi nga dy të kërkuar.
- Kontrata me kamionin me targë AA762PU në pronësi të z. A Z nuk është e saktë për arsye se: Ju jeni qerramarrës dhe jo qeradhënës sipas kontratës së paraqitur. Në këto kushte nuk plotësoni dokumentacioni për dy kamiona me kapacitet mbajtës mbi 15 ton.
- Nuk plotëson kriterin për mjetin Autobot uji pasi kontratat e paraqitura për atobotet e ujit nuk janë deklaruar në shtojcën 10 mbi disponimin e makinerive pra për autobot uji me kontratë qeraje me mjetin me targë TR4239M dhe kontrata tjetër me mjetin AA306OY.

* * *

OPERATORËT EKONOMIK TË KUALIFIKUAR

1. “ **Viante Konstruksion** ” shpk me Nr NIPT-i **K 47103804 L** me ofertë ekonomike : **23 090 997** (njëzetë e tre milion e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh .
2. “ **Ed Konstruksion** ” shpk me Nr NIPT-i **K 61625001 I** me ofertë ekonomike : **24 049 619,3** (njëzetë e katër milion e dyzetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë pikë tre) lekë pa tvsh .

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur informojmë se operatori ekonomik “**Viante Konstruksion** ” shpk me Nr NIPT-i **K 47103804 L** me ofertë ekonomike : **23 090 997** (njëzetë e tre milion e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme .

Ankesa për vlerësimin, JO .

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **BASHKISË KUÇOVË**, bashkë me gjithë dokumentacionin e paraqitur për pjesëmarrje në tender, origjinal ose kopje e njehsuar me origjinalin para Noterit Publik , siç parashikohet në dokumentat e tenderit.

Në zbatim të nenit 21, pika 3 paragrafi i parë, të VKM nr. 914 , datë 29.12.2014, jo me vonë se 60 dite nga publikimi i këtij njoftimi, Autoriteti Kontraktor, njofton Operatorin Ekonomik të

shpallur fitues. Po në zbatim të bazës ligjore të sipërcituar neni 21 paragrafi i dytë, Operatori Ekonomik, duhet ti përgjigjet kërkesës së Autoritetit Kontraktor brënda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit .

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do te procedohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik ”, i ndryshuar .

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21 / 09 / 2020

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Kreshnik HAJDARI